



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/ Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja/ Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development

Bazuar në Rregulloren e UMNİK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtatorë 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë neni 1.3 pika (d) Nenin 5 lidhur me nenin 4 dhe nenin 10 të Ligjit për Blegtorinë e Kosovës Nr. 2004/39 të datës 14. Tetor 2004

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 5/2008
Për mbarështimin e kërmijve dhe vënien në qarkullim të prodhimeve të tyre

Neni 1

Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativë përcaktohen kushtet që duhet të plotësojnë personat fizik dhe juridik që merren me mbarështimin, grumbullimin dhe rregullohet vënia në qarkullim ekonomik e kërmijve.

Neni 2

Definicionet

Shprehjet e përdorura për qëllimet e këtij udhëzimi administrativ kanë këto domethënie:

Helikokulturë – mbarështimi i kërmijve për qëllime ekonomike,

Grumbullim – grumbullimi i kërmijve të rritur që kanë arritur pjekurinë biologjike për përpunim ose për qarkullim,

Regjistri – baza e të dhënave për mbarështimin, grumbullimin dhe vënien në qarkullim të kërmijve.

Paketim origjinal - paketimi në ambalazh të veçantë e cila siguron origjinalitetin dhe kualitetin e prodhimit deri në momentin e hapjes për qëllim konsumi ose përpunimi.

Treguesit biologjikë – marrja e formës, madhësisë dhe fortësisë së guacës (shtëpizës) së kërmillit sipas llojit,

Kontrollit laboratorik i kërmijve – Kontrolli laboratorik i kërmijve që bëhet 3 – 4 ditë pas pastrimit të kërmijve.

Neni 3

Licencimi

(1) Ministria bënë licencimin e personave fizik dhe juridik që merren me mbarështimin dhe grumbullimin e kërmijve për qëllime ekonomike.

(2) Kushtet e licencimit për personave fizik dhe juridik të cilët merren me mbarështimin dhe grumbullimin e kërmijve për qëllime ekonomike përcaktohen sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 9/2004 Për licencimin e veprimtarive të industrisë ushqimore, jo ushqimore dhe ndërtimore dhe certifikimin e produkteve të industrisë bujqësore.

Neni 4

Personat fizik dhe juridik për licencim për mbarështimin e kërmijve duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

- a) Kërkesa për regjistrimin e fermës për mbarështimin e kërmijve,
- b) Dëshmi mbi regjistrimin e biznesit,
- c) Dëshmi nga kadastra për sipërfaqen e parcelës së tokës për mbarështimin e kërmijve,
- d) Pëlqimit nga inspeksioni veterinarë për gjendjen shëndetësore epizotike dhe kushteve zoohigjienike të lokacionit në të cilin është ngritë ferma,
- e) Përshkrimi i kushteve tekniko teknologjike për prodhimtarinë: përshkrimi i shkurtër i kushteve të mbarështimit, llojit të kërmijve që mbarështohen, ushqimi, masat e ndërmarra për parandalimin nga dëmtuesit, masat e ndërmarra për ruajtjen e ekosistemit, mënyra dhe vendi i plasmanit të kërmijve, dhe sipërfaqja e fermës për mbarështimin e kërmijve,
- f) Pëlqimi nga inspeksioni i ruajtjes së ambientit për ruajtjen e balancit të ekosistemit dhe ekosistemit në përgjithësi,
- g) Dëshmi mbi origjinën e rasatit të kërmijve,
- h) Dëshmi nga Institutet e autorizuara mbi distancën prej 50m, nga parcela për mbarështimin e kërmijve, ku sigurohet se nuk ka sipërfaqe të trajtuara me preparate kimike,
- i) Paga në xhironlogarinë e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës

Neni 5

Masat mbrojtëse

(1) Ministria përcakton kushtet dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të plotësojnë fermat që merren me mbarështimin e kërmijve për qëllime ekonomike.

(2) Kushtet dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të plotësojnë feramat për mbarështimin e kërmijve janë të përcaktuara në aneksin i cili është pjesë përbërëse të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 6

Evidenca

Personat fizik dhe juridik që merren me mbarështimin dhe grumbullimin e kërmijve duhet të mbajnë evidencën për sasinë e kërmijve të grumbulluar në vit dhe llojin e tyre.

Neni 7

(1) Evidenca për sasinë e kërmijve të grumbulluar përmban:

- a) Emërtimin e kultivuesit / grumbulluesit,
- b) Numrin personal të licencës,
- c) Adresën dhe vendbanimin e përhershëm,
- d) Datën e grumbullimit dhe vendin e grumbullimit
- e) Llojin e kërmijve,
- f) Sasinë e kërmijve,
- g) Datën e kontrollit laboratorik të kërmijve.

(2) Evidenca është unike konform standardeve.

Neni 8

Mbajtja e Regjistrave për personat fizik dhe juridik

(1) Ministria mbanë regjistrin e personave fizik dhe juridik që merren me mbarështimin dhe grumbullimin e kërmijve për qëllime ekonomike.

(2) Regjistri përmban:

- a) Të dhënat për personin fizik ose juridik,
- b) Sasinë dhe llojin e kërmijve të prodhuar ose të grumbulluar dhe
- c) Vendin ku eksportohen kërmijtë.

Neni 9

Kufizimet

Ndalohet mbarështimi dhe grumbullimi i kërmijve në afërsi të parqeve nacionale, rezervateve të veçanta natyrore dhe /ose hapësirat me rëndësi kërkimore – shkencore.

Neni 10

Për konsum përdoren këto lloje të kërmijve: Kërmijtë laraman (Helix aspersa), Kërmijtë e malit (Helix lucorum), Kërmijtë e vreshtës (Helix pomatina) dhe kultivar.

Neni 11

Vënia në qarkullim e kërmijve

- (1) Kërmijtë që vihen në qarkullim duhet:
- a) të kenë arritur treguesit biologjikë;
 - b) të jenë të gjallë me guacë (shtëpizë) të pa dëmtuar dhe
 - c) të jenë me madhësi të njëjtë,
- (2) Kërmijtë vihen në qarkullim të gjallë ose të konservuar nëse një gjë e tillë nuk është paraparë ndryshe me këtë udhëzim administrativ.

Neni 12

Ambalazhi dhe paketimi

- (1) Ambalazhi për paketimin e kërmijve duhet të jetë:
- a) i qëndrueshëm nga goditjet dhe ndrydhjet, i pastër dhe pa mbetje aromatike. Pas çdo përdorimi ambalazhi duhet të pastrohet, dhe dezinfektohet me preparate dezinfektuese të përshtatshme,
 - b) i tillë që të mundësojë qarkullimin e lirshëm të ujit dhe spërkatjen dhe
 - c) i tillë që të mundësojë ajrosjen dhe qarkullimin e ajrit.
- (2) Ambalazhi për paketimin e kërmijve duhet të ketë veti tjera të cilat mund të kërkohen nga organet e kontrollit të sigurisë së ushqimit dhe shëndetit publik.

Neni 13

Transporti

- (1) Transporti i kërmijve duhet të bëhet në qese rrjetë dhe kuti plastike, druri ose nga metali që nuk preket nga korrozioni.
- (2) Mjeti transportues duhet të jetë i pastër, i dezinfektuar dhe të ketë pajisje ftohëse që të sigurojë temperaturën 4 - 8 °C.

Neni 14

Përmbajtja e etiketës dhe deklaracionit

- (1) Prodhimet në paketime origjinale të cilat vihen në qarkullim në mbështjellës dhe materialin paketues duhet të jenë të etiketuara.
- (2) Etiketa duhet të përmbajë këto të dhëna:
- a) Emrin e prodhimit ose emri tregues i prodhimit,
 - b) Emrin e prodhuesit dhe adresa,
 - c) Vendin e origjinës,
 - d) Numrin serik të prodhimit,

- e) Përmbajtja e prodhimit duke përfshirë edhe aditivë që mund të jenë pjesë përbërëse e prodhimit. Renditja e përmbajtësve të prodhimit duhet të bëhet në bazë të peshës (masës) së tyre në prodhim,
- f) Datën e prodhimit dhe afatin e qëndrueshmërisë gjegjësisht informatën: "mund të përdoret deri më datë" (për prodhimet që kanë afat qëndrueshmërie deri në tre muaj shënohet data dhe muaji ndërsa për prodhimet që kanë afat qëndrueshmërie mbi tre muaj shënohet muaji dhe viti),
- g) Pesha neto e prodhimit,
- h) Udhëzimet për kushtet e ruajtjes dhe deponimit dhe
- i) Udhëzimi dhe mënyra e përdorimit.

(3) Të dhënat duhet të jenë të qarta, të shihen lehtë, të lexueshme dhe të mos shlyhen lehtë.

(4) Etiketa shkruhet në gjuhën zyrtare të Kosovës.

Neni 15

Nëse prodhimi nuk paketohet nga prodhuesi, përveç kushteve të përcaktuara me nenin 14 të këtij Udhëzimi Administrativ etiketa duhet të përmbajë edhe këto të dhëna:

- a) Emërtimi dhe selinë e personit juridik ose emrin dhe adresën e personit fizik që ka paketuar prodhimin dhe
- b) Datën e paketimit.

Neni 16

Përmbajtja e deklaronit

(1) Për vënien në qarkullim të kërmijve në formë të pa ambalazhuar kërkohet vendosja e deklaronit me të dhënat:

- a) për sasinë dhe llojin e kërmijve dhe kushtet e përcaktuara me nenin 14 të këtij Udhëzimi Administrativ,
- b) të dhënat e eksportuesit dhe vendin e eksportimit,

(2) Deklaracioni duhet të vendoset në vend të dukshëm.

Neni 17

Mbikëqyrja dhe inspektimi

(1) Mbikëqyrjen dhe inspektimin e prodhimit dhe grumbullimit e bënë Inspektori veterinarë.

(2) Prodhuesi është i detyruar që në çdo kohë, kur t'i kërkohet nga inspektori veterinarë, t'i ofroj të dhënat e kërkuara.

Neni 18

Dispozitat ndëshkimore

Mos zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativë sanksionohet me dispozitat e nenit 25 (h), (j) dhe (k) dhe paragrafi 2 dhe 3 të nenit 26 të Ligji për Blegtorinë e Kosovës Nr. 2004 / 33.

Dispozitat përfundimtare

Neni 19

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Datë: 14.03. 2008

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Idriz Vehapi



Aneksi

Sipas Nenit 4 pika 2 Kushtet dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të plotësojnë feramat për mbarështimin e kërmijve duhet të plotësojë këto kushte:

1. Përzgjedhja e sipërfaqes

Sipërfaqja e tokës për mbarështimin e kërmijve duhet të plotësojë këto kushte:

- a) Sipërfaqja e tokës nuk duhet të jetë në afërsi të zonave me potencial vërshtues të ujërave,
- b) Sipërfaqja e tokës duhet të jetë e melorueshme dhe të mos përmbajë ujëra sipërfaqësorë,
- c) Duhet të përcaktohet lloji i tokës dhe përmbajtja e metaleve të rënda në dhe,
- d) Aciditeti, pH e tokës të jetë 5.8 -7.5, sipas llojit të helikokulturës dhe
- e) Përmbajtja e kalciumit të asimilueshëm në dhe duhet të jetë nga 1,5 – 2 %,

2. Përgatitja e tokës

Përgatitja e tokës për mbarështimin e helikokulturave:

- a) Duhet të sigurohet lagështi të mjaftueshme 75 – 80 % sipas llojit të heikokulturës,
- b) Rrethojat e sipërfaqes së parcelës duhet të vendosen në thellësi deri në 40 cm. ndërsa e rrjetit të posaçëm për mbrojtjen e sipërfaqes (eurohelix) për kultivimin e kërmijve duhet të vendoset në thellësi deri në 10 cm.
- c) Dimensionet e katrorëve të rrjetit për ruajtjen e kërmijve duhet të jenë 2.5 mm. në dyshe dhe 4 mm. në lartësi,
- d) Lartësia e rrethojës së vendit për mbarështimin e kërmijve duhet të jetë deri në 60 cm.
- e) Duhet të bëhet dezinfektimi i dheut menjëherë pas përgatitjes së parcelës dhe
- f) Vendosja e kërmijve mund të bëhet 60 ditë pas dezinfektimit dhe deratizimit të tokës.

3. Masat mbrojtëse

Për mbrojtjen e helikokulturave duhet të ndërmerren masat në vijim:

- a) Në rast të invazionit nga insektet kërmijë lejohet të mbrohen përmes aplikimit të insekticideve me bazë nga ekstraktet bimore ose preparate melathionina me përqendrim nga 3 – 5 %,
- b) Gëlqerja e pa shuar në formë pluhuri mund të përdoret si material dezinfektues për parcelën ku vendosen kërmijë dhe në vendkalimet në mes parcelave.
- c) Për trajtim të rregullt me pesticide si masë preventive për parandalimin e sëmundjeve të bimëve ushqyese për kërmij lejohet përdorimi i pesticideve me bazë nga organo fosfori,
- d) Duhet të ndërmerren masa mbrojtëse për mbrojtje nga grabitqarët. Pajisjet mbrojtëse duhet të jenë në lartësi nga 60 – 90 cm. dhe
- e) Rrjeti i posaçëm për mbrojtjen e sipërfaqes (eurohelix) duhet të jetë 100 % nga polietileni.